



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4762 Prot.

Ballsh, më 29.09.2022

VENDIM

Nr. 52 Datë 28.09.2022

PËR

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR
PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË NEGOCIMIT ME BASHKITË E QARKUT
FIER, PËR REALIZIMIN E PROCEDURAVE TË MARRJES NË DORËZIM SIPAS
DETYRIMEVE TË KONTRATËS "PËR NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E
IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER", NË
BASHKITË E QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nr. 12, datë 24.02.2020, "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër", si dhe të shkresave nr. 3413 prot., datë 26.04.2022; nr. 3413/1 prot., datë 14.07.2022 dhe nr. 3413/4 prot., datë 31.08.2022 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Kontratës "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier",

VENDOSI

1. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Mallakastër, të fillojë negocimet dhe të nënshkruajë çdo marrëveshje të nevojshme me të gjithë Bashkitë e Qarkut Fier për realizimin e procedurave të transferimit të asetëve, konform nenit 22 të kontratës konçensionare "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier" datë 24.10.2016.

KRYETAR
FITIM BARAJ

